

KËRKIME GJUHËSORE

Migena KAPLLANI

FRAZA PARAFJALORE DHE FUNKSIONET E SAJ NË GJUHËN SHQIPE

(në kuadrin e teorisë së valencave)

Gramatika e varësisë ose gramatika e valencave, në variantet e saj aktuale, edhe pse derivat i rrymës strukturaliste, gjallon sot vitale dhe moderne në fushën pa anë e pa fund të mendimit gjuhësor. Nuk ka sot truall të mendimit gjuhësor, ku *teoria e valencave* të mos ketë domenin e vet. Ajo zhvillohet si rrymë e fuqishme, krahas rrymave të tjera dhe në fushën e mësimit të gjuhëve të huaja ka dhënë ndihmesa të veçanta. Në ditët e sotme është vështirë të gjejmë një gramatikë (edhe ndër ato më tradicionalet) që të shpërfillë teorinë e valencave. Shumica e gramatikave europiane e fillojnë analizën e materialit gjuhësor me foljen, kjo do të thotë që foljes i kushtohet vëmendje qendrore.

Kjo teori (e valencës), lindi në vitet 60 si një drejtim i gramatikës strukturore. Detyra kryesore e gramatikës strukturore është të përshkruajë sistematikisht lidhjet e fjalëve në fjali. Në këtë mënyrë vështirimi ajo dallohet nga gramatika tradicionale që interesohet më shumë për fjalën e veçantë, për klasifikimin e fjalëve në pjesë ligjëruese, për fleksionin e fjalës.

Fjalja është forma më e zakonshme e shprehjeve gjuhësore, kështu që njohja e strukturës së fjalës është me shumë rëndësi në mësimin e gjuhës, kjo mundëson depërtimin në strukturën e gjuhës.¹ Kjo teori bazohet në domosdoshmërinë e shoqërimit të foljeve me gjymtyrë plotësuese (*Ergänzungen*). Për të ruajtur fjalja gramatikalitetin e saj, folja duhet të shoqërohet me një numër të caktuar gjymtyrësh. Sipas valencës së foljes, përcaktohet struktura e fjalës.

Gjymtyrë qendrore merret folja, e cila sipas kësaj teorie nuk quhet kallëzues dhe duke qenë gjymtyrë kryesore rrëzon skemat me dy gjymtyrë kryesore dhe tri gjymtyrë të dyta. Gjymtyrët plotësues janë gjymtyrë të domosdoshme në parim dhe ne do t'i quajmë plotësa të cilët ndryshojnë nga rrethanorët mund të hiqen apo lëvizin lirisht në fjali dhe lidhen me folje të ndryshme.

Nuk duhet të ngatërrohen konceptet *rrethanor* i cili hiqet dhe vihet lehtësisht në fjali dhe termit *gjymtyrë fakultative*. Këto të fundit janë plotësa. Si plotësat dhe rrethanorët janë të varura nga folja, por *plotësat janë të detyrueshëm në parim*, lidhen me një folje të caktuar dhe kur janë me parafjalë mund të zëvendësohen me maksimumi dhe një parafjalë tjetër, kurse rrethanorët janë të lëvizshëm, mund të hiqen dhe nuk ndryshojnë asgjë në plotësinë e kuptimit të fjalës, gjithashtu, parafjala e vendosur përpara, mund të zëvendësohet me disa të tilla. Rrethanorët lidhen me çdo folje.² P.sh., në fjalinë *Libri është mbi tryezë*, në këtë rast plotësi me parafjalë, *mbi tryezë*, nuk mund të hiqet, sepse fjalja humbet

¹ E. Sadiku, *Hapa në Universin e Ligjëritit*, Tiranë, 2010, f. 13-14.

² U. Engel, *Syntax der deutschen Gegenwartssprache*, Berlin 2009, f. 57.

gramatikalitetin e saj. Plotësi krijon me foljen lidhje semantiko-gramatikore. Është kjo folje që e kërkon si nga ana *gramatikore* plotësin ashtu dhe nga ana *semantike*. Parafjalën e tij nuk mund ta zëvendësojmë me ndonjë parafjalë tjetër ose mund të zëvendësohet me një numër të kufizuar dhe jo me pafundësi parafjalësh si do të ishte me rastin e rrethanorit. Ne fjalinë *Unë këndoj në kopësht*, mund të hiqet fare *në kopësht* dhe fjalia të mos humbasë kuptimin e saj, ose mund të ndryshojë nga *në kopësht*, *në shtëpi*, *në koncert*, dhe përsëri fjalia apo folja e ruan kuptimin.

Unë këndoj *në shtëpi*.

Unë këndoj *në koncert*.

Folja *këndon*, kërkon si plotës të domosdoshëm subjektin, ndërsa objektin nuk e ka të domosdoshëm, por fakultativ. Rrethanorë kjo folje merr sa të duash, ndërsa plotës të domosdoshëm merr një dhe fakultativë një. Pra përmes valencës së foljes, kërkesës që ka ajo, plotësohet një fjali. Valenca është aftësi semantiko-gramatikore që realizohet përmes plotësave.³ Rrethanorët nuk janë gjymtyrë të detyrueshme, sepse folja nuk e kushtëzon përdorimin e tyre. Shpesh krahasimin e koncepteve të valencës e bëjmë me ato të gramatikës tradicionale, sepse teoria e valencës nuk vjen nga hiçi, por është brenda saj, e mbështet atë, duke sjellë ndryshime e zhvillime specifike. Për më tepër krahasimet i bëjmë shpesh me gramatikën tradicionale, pasi kjo e fundit përmban forcën e zakonit.

Kryesisht për ta dalluar kundrinorin me parafjalë nga rrethanori, në gramatikën tradicionale, përdoret pyetja; vetëm gjymtyra që ka në ndërtimin e vet parafjalë dhe që vjen si përgjigje për pyetjen trajtohet si kundrinor me parafjalë si dhe kur pyetja bëhet si me përemër, ashtu dhe me ndajfolje⁴. Por theksohet dallimi i parafjalëve që përdoren vetëm për kundrinorë, për kundrinorë e rrethanorë dhe vetëm për rrethanorë⁵; p.sh. mbaj mëri *me vëllanë* (me kë?)

Ndërsa në teorinë e valencave, dallimi plotës dhe rrethanor, bëhet në varësi të foljes dhe kërkesës së saj për t'u plotësuar me gjymtyrë. Termi plotësor, nuk është përcaktuar si gjymtyrë fjalie, por si një element përbërës i domosdoshëm në fjali. Në literaturën e sotme gjuhësore, në kuadrin e teorisë së valencave, bëhet dallimi midis plotësave të detyrueshëm në parim (pra edhe fakultativë) dhe rrethanorëve që janë gjithnjë fakultativë.

Në shqipen e sotme letrare ka dhjetë lloje plotësash. Numri i tyre është përcaktuar me ndihmën e anaforave ose me anë të anaforizimit. Kjo është një metodë e përdorur nga Engeli (Ulrich Engel, *Syntax der deutschen*

³ Po aty, f. 87.

⁴ R. Përnaska, *Çështje të kundrinorit në gjuhën shqipe*, Studime filozofike, Nr. 4, Tiranë 1983.

⁵ Po aty. ...vihet re se në gjuhën shqipe ka a) parafjalë e shprehje parafjalore që shërbejnë për të ndërtuar vetëm kundrinorë ose kryesisht kundrinorë si *kundër*, *ndaj nëpërmjet*, *me anën e*, *me anë të*, *në vend të*, *në kundërshtim me*, *bashkë me*, *në lidhje me*, *në raport me*, *në krahasim me*; b) parafjalë që shërbejnë për të ndërtuar edhe kundrinorë, edhe rrethanorë, si *nga*, *tek*, *me*, *për*, *pa*, *mbi*, *nën*, *para*, *rreth*, *kundrejt*; c) parafjalë që shërbejnë për të ndërtuar vetëm rrethanorë, ose kryesisht rrethanorë si *larg*, *afër*, *përmes*, *sipër*, *gjatë*, *rrotull*, *kundruall* etj.

FRAZA PARAFJALORE DHE FUNKSIONET E SAJ NË GJUHËN SHQIPE

Gegenwartssprache, Berlin, 2009)⁶ për të përcaktuar me saktësi klasat e plotësive. Sipas kësaj metode plotësat mund të rijepen ose të rimerren me anë të fjalëve deiktike ose me anë të shprehjeve anaforike. Si të tilla në gjuhën shqipe shërbejnë kryesisht përemrat dhe ndajfoljet.

Në lidhje me frazën parafjalore, ajo mund të dalë si;

- plotës parafjalor (i njëjtë me kundrinorin e zhdrejtë me parafjalë)
- plotës situativ, në rastin e plotësit me parafjalë që shënon situatën në të cilën gjendet diçka
- plotës drejtimi, plotës që shënon drejtimin e një lëvizjeje
- plotës ekspansiv (kohor, hapësinor)

Plotësi me parafjalë. Dukuria në fjalë shënohet në “Gramatikën e Gjuhës Shqipe”,⁷ me termin *kundrinë e zhdrejtë me parafjalë*. Kështu, nuk bëhet ndonjë dallim kategorial ose funksional midis kundrinës së zhdrejtë dhe asaj me parafjalë. Në këtë trajtim mbi klasën e plotësive, ku klasifikimi është bërë sipas parimit të anaforizimit, nuk mund të pranohet përfshirja nën një emërtim e plotësit dhanor (kundrina e zhdrejtë) dhe e atij parafjalor. Sipas kësaj metode klasifikuese këto dy madhësi u përkasin grupeve të ndryshme. Ato paraqesin ndryshime rendesh të ndryshme: semantike, gramatikore, funksionale. Plotësi parafjalor është gjymtyrë që varet nga folja. Ai anaforizohet (mund të zëvendësohet) me një përemër me parafjalë⁸ dhe shprehet me:

Parafjalë + frazë emërore: *Ne punuam për skenarin.*

Parafjalë + frazë përemërore: *Unë dua të takohem me ty.*

Forma e plotësit me parafjalë, mund të ngatërrohet me formën e një rrethanori.⁹ U theksua dhe më lart që rrethanorët janë lehtësisht të lëvizshëm në fjali. Statusin plotës apo rrethanor ia jep dhe nevoja sintaktike që ka fraza për to. Nëse e heqim nga fjalia dhe ajo eliminimi i tij e kthen fjalinë jogramatikore, atëherë kemi të bëjmë me një plotës.

E vrau për xhelozin./ E vrau.

Për xhelozin, mund të hiqet pra kemi të bëjmë me një rrethanor.

Vrasja ndodhi për xhelozin.

**Vrasja ndodhi.*

Në këtë rast shihet që fjalia humbi gramatikalitetin e saj, pra grupi *për xhelozin* është plotës. Bëhet fjalë për një plotës të domosdoshëm. Nëse fraza emërore është një përemër i vetës së tretë në kallëzore ose rrjedhore, ajo mund të dalë në formë të plotë ose në formë të shkurtuar: *me atë/ me të; prej atij/ prej tij*. Kështu p.sh.¹⁰; të blente tokë *për të bijtë(për ta)*; [anaforizohet me një përemër plus parafjalën, nuk mund ta heqësh së humbet kuptimin si dhe parafjala nuk mund të zëvendësohet me një tjetër]

⁶ E. Sadiku, *Hapa në Universin e Ligjërimit*, Tiranë, 2010, f. 24.

⁷ *Gramatika e gjuhës shqipe* 2, Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë 2002, f. 260.

⁸ U. Engel, *Syntax der deutschen Gegenwartssprache*, Berlin 2009, f. 135.

⁹ E. Sadiku, *Hapa në universin e ligjërimit*, Tiranë, 2010, f. 24.

¹⁰ M. Camaj, *Pishtarët e natës*, Tiranë, 2010.

tue luftue për Turkun;
jeta do dhanë për një copë bukë;
s' e qiti në krye me Nikën; tërhiqet me familje;
i binte malli për grue;
u këshillue me të kunatën;
jam e zanun me rangët e shtëpisë;
ia çonte përmes të bijve; solli me të;
u veçue nga familja nga shokët;
e ndalte me fjalë larg punëve të veta.

Dallimi midis këtyre dy grupeve është ndonjëherë i vështirë. Veç ata kanë status të ndryshëm semantiko-sintaksor.¹¹

Plotësi parafjalor mund të jetë i domosdoshëm ose fakultativ: *Çdo javë marr letra prej saj.* (fakultativ) / *Ai flet vetëm për të.* (i domosdoshëm)

Plotësi situativ. Edhe ky plotës, del si frazë parafjalore. Ky plotës ka një kuptim të qartë: shënon, jep situatën në të cilën gjendet diçka.... Del në bashkëvjatje me folje që tregojnë vendndodhje, si *jam, gjendem, rri, banoj, varet, ulem* etj. Plotësi situativ shënon zakonisht vend. Mund të dalë me ose pa parafjalë. Është gjithnjë *gjymtyrë e domosdoshme* e fjalisë. Format me parafjalë me të cilat realizohet janë:

1. Frazë parafjalore: *Ajo banon në katin e dytë.*
2. Parafjalë + frazë përemërore: *Eja të rrih tek unë.*

Anaforizimi bëhet me parafjalë + përemër ose me ndajfolje: *Agimi banon tek e motra. (tek ajo, atje).*

¹¹ Për identifikimin e plotësive parafjalorë përdoren këto metoda:

♦ Anaforizimi: Plotësi parafjalor anaforizohet me një parafjalë + një përemër: *Ai më foli për shkrimtarin francez.* (për të).

Pjesa më e madhe e rrethanorëve anaforizohen me ndajfolje: *Në klasë bën ftohtë.* (Atje/ këtu bën ftohtë.).

♦ Verifikimi nëse parafjala është e këmbyeshme apo jo. Te plotësat parafjalorë parafjala nuk është e këmbyeshme: *Ai mendon për familjen.* Parafjala *për* nuk është e këmbyeshme siç është parafjala *në* në fjalinë: *Librin e lashë në/mbi tavolinë/ sipër tavolinës.*

Ndërsa në ndërtimin e rrethanorëve ka mundësi të shumta në zgjedhjen e parafjalëve, në ndërtimin e plotësive parafjalorë përdoren vetëm parafjalë të caktuara; për çdo folje që drejton një plotës parafjalor destinohet një parafjalë dhe kjo parafjalë nuk është e këmbyeshme. Vetëm në pak raste mund të bëhet fjalë për më shumë se një parafjalë, por gjithësesi numri i parafjalëve të mundshme është shumë i kufizuar. Një kufizim i tillë nuk ndodh në ndërtimin e rrethanorëve.

♦ Parafjala e plotësit parafjalor nuk ka kuptim të pavarur, por formon një unitet kuptimor me emrin a përemrin me të cilët lidhet. Parafjalë të tilla janë bosh kuptimisht.

Dje diskutuam për romanin e tij.

Atje bëhet fjalë mbi një film të ri.

E. Sadiku, *Hapa në universin e ligjërit*, Tiranë, 2010, f. 25.

FRAZA PARAFJALORE DHE FUNKSIONET E SAJ NË GJUHËN SHQIPE

Shembuj të plotësive situativë: e zente nata në *Fundinë*; mbas darkës shtrihej te ura e votrës ku flenin zakonisht miqtë e huej; ngushtohen (mbeten keq) atje nalt; u ndalën te uji i lagësishës etj.

Plotësi i drejtimit. Siç e tregon dhe emri ky plotës shënon drejtimin e një lëvizjeje, pikënisjen, pikëmbërritjen ose hapësirën e përshkruar. Ky plotës shoqërohet zakonisht me folje që tregojnë lëvizje, si *shkoj, udhëtoj, vrapoj, nxitoj etj.* Edhe ky lloj plotësi shprehet me:

1. Faza parafjalore: *Ajo do vazhdojë studimet në Francë. / Makina u nis për Tiranë.*

Plotësat e drejtimit mund të jenë fakultativë ose të domosdoshëm: *Ai shkoi në Fundinë.* (i domosdoshëm) / *Fushës vraponte një lepur.* (fakultativ).

Në fjali mund të përdoren njëkohësisht dy plotësa drejtimi. Në këtë rast shënohet pikënisja dhe pikëmbërritja e lëvizjes: *Dy gurë të mëdhenj ranë nga mali në përrua.*

Në gjuhën shqipe plotësi i drejtimit dhe plotësi situativ dalin me formë të njëjtë gramatikore. Ndryshimi qëndron në kuptimin e tyre dhe në foljet drejtuese. Plotësi i drejtimit anaforizohet me ndajfolje: *atje, këtu, prej andej, prej këtu etj.*

Shembuj të plotësive të drejtimit: dalëngadalë u tërhoq te prona ndër Gurra; kur shkonte për treg në *Shkodër*; dhe mbas muzgut vonë, kthente në *plang*; shko në *Fundinë*; po ulet bashkë me Palin në *Pazar etj.*

Po kështu mund të shohim edhe rastet e përdorimit të frazës parafjalore në formën e plotësit ekspansiv i cili shpreh një ndryshim kohor ose hapësinor, ose një zgjerim.¹² Disa shembuj me parafjalë mund të jenë: të zbriste te *shtëpia e vendit*; që bien prej *shkallë në shkallë deri në lumin e Vitos*; ata afër *agimit* të gjithë fikeshin në qiell; të atin e kishte ndërmend prej fillimit *deri në atë ditë*; prej perëndimit të diellit *deri në muzg*, avullina ndërronte dukje; u prina *deri në lumë*; për t'i bartë *deri në Shkodër*; *deri tash vonë*

Mund të ketë edhe nga ato të mënyrës dhe pse më rrallë, me formën *sipas.....* p.sh. Ne duhej të vepronim *sipas rregullave në fuqi.*

Modelet kryesore të fjalive i gjejmë të plotësuara me frazën parafjalore. Kjo shumëllojshmëri rastesh të ndërtimit të fjalisë, rrit rëndësinë e studimit të kësaj fraze. Ajo mund të jetë e paraprirë nga parafjalë të rasës emërore, kallëzore, rrjedhore të tipit: shuhej me..., ngatërroj me..., ndalon te..., shkon te..., zbres te..., tërheq te..., dal përpara..., hyj në..., ra në..., fle në..., bie në..., blej për..., luftoj për..., dal për..., pyes për..., jetoj për..., nxjerr prej..., marr prej..., shpërthen prej..., dalloj prej..., bie prej..., presin deri...etj.

Faza parafjalore, zë një vend të rëndësishëm në ndërtimin e fjalisë. Ajo është e larmishme për vetë formën që ka dhe larminë e parafjalëve. Plotësi parafjalor, apo dhe rastet e tjera që paraqiten si fraza parafjalorë, dallojnë nga rrethanorët dhe janë gjymtyrë plotësuese të fjalisë. Nëse lidhja midis foljes dhe frazës parafjalore është e kushtëzuar nga përzgjedhja semantike e foljes, atëherë ajo shërben si plotësor, në rast të kundërt shërben si rrethanor.

¹² E. Sadiku, *Hapa në universin e ligjërit*, Tiranë, 2010, f. 28.